UNIVERSITETI I PRISHTINËS ”HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

PUNIMI I DIPLOMËS - MASTER

TEMA :

KRAHASIMI NDËRMJET GRUPEVE NË DISA NDRYSHORE MORFOLOGJIKE, LËVIZORE BAZIKE DHE SITUACIONALE TEK BASKETBOLLISTËT E RINJ

Mentori:
Prof. dr. Hazir Salihu

Kandidati / ja:
Ahmet Ajdini
&
Xhevahire Hajda

Prishtinë, 2018

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....1
2. HULUMTIMET E DERITANISHME.....3
3. QËLLIMI I PUNIMIT.....6
3. 1. HIPOTEZAT THEMELORE.....7
4. METODOLOGJIA E PUNËS.....8
4.1. Mostra e entiteteve.....8
4.2. Mostra e ndryshoreve antropometrike.....9
4.2.1. Përshkrimi i ndryshoreve antropometrike.....9
4.3. Mostra e ndryshoreve lëvizore bazike.....12
4.3.1. Përshkrimi i ndryshoreve lëvizore bazike 13
4.4. Mostra e ndryshoreve lëvizore situacionale.....17
4.4.1 Përshkrimi i ndryshoreve lëvizore situacionale 17
4.5. Përshkrimi i instrumenteve të përdorura gjatë matjeve 24
4.5.1. Përshkrimi i procesit të matjeve 25
5.METODA DHE PËRPUNIMI I REZULTATEVE.....26
6. REZULTATET DHE DISKUTIMET 27
6.1. Treguesit themelor statistikor në hapësirën antropometrike dhe motorike të basketbollistëve për katër ekipet 27
6.1.1 Treguesit themelor statistikor në hapësirën antropometrike të basketbollistëve ...27
6.1.2. Treguesit themelor statistikor në hapësirën motorike të basketbollistëve.....28
6.3.Korelacionet e ndryshoreve manifeste.....29
6.3.1. Korelacionet ndërmjet ndryshoreve në hapësirën antropometrike.....29
6.3.2. Korelacionet ndërmjetë ndryshoreve në hapësirën motorike 30
6.3.3. Kros korelacionet e ndryshoreve në hapësirën antropometrike dhe motorike.....31
6.4. DALLIMET NË HAPËSIREN MANIFESTE.....32
6.4.1 T-testi për ndryshoret antropometrike dhe lëvizore ndërmjet ekipeve 32

6.4.1.1. T - Testi ndërmjet basketbollisteve të Kerasan Prishtinës dhe M - Junorit në hapësirën antropometrike dhe motorike.....32
6.4.1.2. T - Testi ndërmjetë basketbollisteve të Kerasan Prishtinës dhe Trepçës në hapësirën antropometrike dhe motorike.....34
6.4.1.3 - Testi ndërmjetë basketbollisteve të Kerasan Prishtinës dhe Vushtria Basket në hapësirën antropometrike dhe motorike.....36
6.4.1.4 T - Testi ndërmjetë basketbollisteve të M - Junorit dhe Trepçës në hapësirën antropometrike dhe motorike.....38
6.4.1.5 T - Testi ndërmjetë basketbollisteve të M - Junorit dhe Vushtria Basket në hapësirën antropometrike dhe motorike.....40
6.4.1.6 T - Testi ndërmjetë basketbollisteve të Trepçës dhe Vushtria Basket në hapësirën antropometrike dhe motorike.....42
7.ANALIZA DHE VËRTETIMI I HIPOTEZAVE TË SHTRUARA.....44
8.PËRFUNDIMI.....45
9.ABSTRAKTI.....46
9.ABSTRACT..... 47
10. BIBLIOGRAFIA.....48
11. PARAQITJA GRAFIKE E REZULTATEVE PËR KATËR EKIPET NË HAPËSIREN ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE 50

1.HYRJA

Basketbolli si lojë karakterizohet me lëvizje polistrukturale dhe komplekse, ku hyjnë lëvizjet ciklike dhe aciklike, lëvizje këto që janë të ndërlidhura në nivelin e lartë të përgaditjes fizike.

Basketbolli i ditëve të sotme, është bërë sport shumë kompleks dhe atraktiv, duke iu falënderuar zhvillimit të koncepteve sistematike nga ana e ekspertëve botëror. Përsosja e tyre është bazuar në imagjinatën si pjesë e të menduarit në krijimtarinë e basketbollit.
Basketbolli është sport që kërkon lëvizje të ndryshme dhe nuk është më sport i butë (pastërt) si më parë, pasi që lojtarët bashkëkohorë nuk janë si lojtarët e mëparshëm pasi ata duhet të jenë më të fuqishëm dhe më të shkathët, të jenë më të lëvizshëm për veprime (reaksione) dhe improvizues të tri elementeve kryesore të basketbollit si: Driblimi, Pasimi dhe Gjuajtja në kosh, pra të kenë një dominim të aftësive motorike si aksioni dhe reaksioni. Po ashtu në basketbollin modern rëndësi të madhe është duke iu kushtuar vendosjeve për faul në sulm që kërkon shpejtësi, koncentrim dhe reagim në kohë dhe hapësirë, kontakti me bllok-out, ndërprerja e lëvizjeve të kundërshtarit dhe shkatërrimi (çrregullimi) i sulmeve si dhe ndërprerja e pasimeve dhe pranimeve të topit afër zonës, përmirësimi i teknikës së vendosjes në mbrojtje dhe sulm aftësia për kërcime të shpejta eksplozive në mbrojtje dhe sulm dhe në fund përmirësimi i shpejtë gjatë kalimit nga një fazë në fazën tjetër në lojë të basketbollit.

Në gjithë këtë ka ndikuar përmirësimi sistematik i rregullave të basketbollit dhe futja e risive te reja që ka ndikuar në rritjen e nivelit të lojës dinamike dhe atraksionet. Me një fjalë dëshira për këtë sport dhe nevoja për tu shoqëruar, ka përfituar çdo kënd në oazën e vogël të basketbollit.

Hulumtimet në basketboll paraqesin informata të cilat pa dyshim dëshmojnë ekzistimin si dhe ndikimin e shumë faktorëve në realizimin e detyrave komplekse motorike.

Që nga zanafilla e lojës së basketbollit, trajnerët dhe ekspertët kanë qenë në kërkim të vazhdueshëm të formave dhe rrugëve të reja të zhvillimit dhe avancimit sa më të hovshëm të sportit të Basketbollit.

Duke u bazuar në këtë dinamika e kërkimeve dhe hulumtimeve në avancim të sportit të basketbollit nuk ka të ndalur. Edhe ky hulumtim në lëmin e lojës së basketbollit do të jetë në shërbim të ngritjes së nivelit të lojës së basketbollit për grupmoshat e reja sepse edhe ashtu është mjaftë i adhuruar në vendin tonë.

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Në lëmin e sportit në përgjithësi e në hapësirën motorike në veçanti janë bërë shumë hulumtime, me grupmoshat nga më të ndryshmet, ku me hulumtimet e bëra deri më tani për njohjen e karakteristikave morfologjike dhe motorike si dhe ndërlidhjet ndërmjet këtyre hapësirave, si dhe ndryshimet ndërmjet grupeve të ndryshme kanë qenë temë e shumë hulumtuesve në lëmin e basketbollit dhe të sporteve tjera, ndër autorët të cilët janë marrë me këto hulumntime janë:

Nixha, M., (1982) në punimin " Analiza kooperative e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese". Mostra e etniteteve kanë qenë tri ekipe të para të ligës së dytë të ish federatës së atëhershme dhe tri ekipet e para të ligës së parë të Kosovës në sezonin 1981 / 1982.

Nixha, M., në vitin 1985, në disertacionin e doktoratës "Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese dhe analiza komparative me volejbollistë dhe hendbollistë", ku si mostër entitetesh ka marrë lojtarët e tri rangjeve, kurse mostra e ndryshoreve ka qenë 11 antropometri dhe 7 motorikë.

Salihu. H., në vitin 2000, në punimin e magjistraturës, ka testuar relacionet e disa karakteristikave trupore dhe aftësive motorike, bazike situacionale tek basketbollistët e moshës 14+ 6 muaj. Si model(mostër) e këtij punimi i cili përfshin 108 basketbollistë të rinj të gjinisë mashkullore, të qytetit të Prishtinës, ku për model të ndryshoreve ka morfologjinë dhe ka aplikuar 10 teste, dhe aftësive motorike situacionale (5) teste, dhe (5) teste tjera nga aftësitë motorike të përgjithshme apo bazike.

Salihu,H., në vitin 2003, në disertacionin e doktoraturës, me titull "Ndryshimet e zhvillimit të veçorive morfologjike dhe aftësive motorike të basketbollistet e rinj" . Studimi ka përfshirë numrin e 161 basketbollistëve të moshës 16 vjeç, dhe atë testimin

fillestar dhe përfundimtar. Në hapësira morfologjike ka përfshirë (11) teste, ndërsa në hapësirën motorike bazike dhe situacionale ka përfshirë 12 teste, nga testimi fillestar dhe përfundimtar. Nga hapësirat e testeve morfologjike janë fituar tre faktorë, ndërsa tek hapësira e testeve motorike, bazike e situacionale, janë fituar 4 faktorë me rëndësi të vlefshme .

Rushiti. H., :. Struktura faktoriale e dimensioneve morfologjike dhe relacioni i tyre me disa aftësi lëvizore tek të rinjtë e moshës 13 – 14 vjeç. Mostra e përbërë prej 205 nxënësve ka vërtetuar strukturën dhe relacionet e rëndësishme ndërmjet sistemit të variableve morfologjike (18) dhe atyre lëvizore (12) të fituar dy faktorë morfologjikë dhe tre faktorë lëvizorë. Punim i Magjistraturës në Prishtinë – 1999.

Gabrijelic.M., me 1977 ka hulumtuar, në mostrën prej 222 sportistëve kulminantë të rangut federativ, të moshës 18-25 vjeç, anëtar të kategorisë së sporteve mashkullore, basketboll (54), futboll (52), volejboll (58), hendboll (58), lidhmëria e dimensioneve manifeste latente, të përgjithshme dhe specifike motorike, kognitive dhe konative me sukses në secilën lojë sportive posaçërisht, atë e ka bërë analizën komparative të lojërave sportive. Janë përdorur 16 teste universale në të gjitha grupet e të testuarve, dhe atë nga tre teste specifike situacionale për secilën lojë sportive. Aftësitë e basketbollistëve kulminant në krahasim me sportet tjera janë renditur si në vazhdim : Basketbollistët janë superior në forcën eksplozive të këmbëve dhe duarve, kurse më inferior në shpejtësinë e vrapimit. Përveç kësaj të gjitha dimensionet manifestuese të neurotizmit gjeneral të basketbollistëve janë më se paku të shprehura në raport me tri lojërat tjera sportive.

Aliu.A., Zhvillimi morfologjik dhe disa kateristika motorike të populates dhe diferenca kronologjike të moshës së caktuar. Në mostrën e entiteteve prej moshës 15-17 vjeç me anë të 18 ndyshoreve ka trajtuar statusin antropometrik me ç' rast ka ekstrahuar tre dimensioned latent: Dimensioni i parë është identifikuar si " dimensioni qarkor i skeletit" , i dyti është "faktori i indit dhjamor nënlëkuror" , i treti "dimensioni transversal i skeletit".

Johan.Z., Në vitin 1991, ka bërë hulumtimin me mostër prej 124 entitete, të ndara në grupe të caktuara, duke preferuar ndonjë sport e në mesin e tyre edhe basketbollin. Autori ka trajtuar 11 teste antropometrike dhe 11 teste motorike gjatë përpunimit të rezultateve është aplikuar analiza kanonike- diskriminative. Grupi deskriminativ më i mire ishte kërcim së gjati nga vendi dhe kërcim trehapësh nga vendi, këta dy faktorë diskriminativ, kanë qenë të vlefshëm, faktori i parë i determinuar sipas matjeve antropometrike, ndërsa faktori i dytë sipas testeve motorike. Sipas këtyre rezultatetet të cilat janë fituara, vijmë në konkludim se këto rezultate janë në përputhshmëri me hipotezën e parashtruar, mirëpo kërkojnë hulumtim të mëtejmë, e sidomos në mostrën e paraparë të basketbollisteve të zgjedhur, që të verifikohet ekstrahimi i dimensioneve latent motorike – situacionale. Këta dy faktorë diskriminativ janë sinjifikant.

Tancing.S., dhe Dezhman.B., në vitin 1989, ka bërë hulumtime me qëllim të vërtetimit të disa ndryshimeve të basketbollistëve të rinjë, të cilët luajnë nëpër vende të ndryshme. Mostra e entiteteve ka përfshirë 102 basketbollistë të moshës mesatare prej 15-5 vjeç, dhe i ka ndarë sipas roleve që luajnë në lojë. Mostra ishte e përbërë prej 25 testeve, kurse rezultatet e hulumtimit i kanë bërë përmes statistikës deskriptive dhe analizës kanonike. Ndërkaç sipas të dhënave autorët kanë konstatuar se lojtarët fundor (1 dhe 2), në basketboll posedojnë rezultate më të mira në krahasim me rolin e qendrave. Kjo tregon se struktura e modelit bek – qendër është e kundërt, deri sa lojatarët anësor gjenden ndërmjet vërtetimit të të dhënave të matjeve.

3. QËLLIMI DHE DETYRAT E PUNIMIT

Qëllimi i këtij punimi është të hulumtohet hapësira antropometrike dhe të bëhet krahasimi ndërmjet katër grupeve të basketbollistëve të rinj, basketbollistëve "KB Kerasan Prishtina" , "KB M Junior" ,"KB Vushtria Basket" dhe "KB Trepça" në disa ndryshore morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale tek basketbollistët e rinj dhe ndërlidhjen e tyre mes veti. Qëllimi tjetër i këtij punimi ishte që të vlerësohen aftësitë për lojën e basketbollit për këta të rinj të gjinisë mashkullore të moshës 13 – 14 vjeç, të cilët përveç orëve të rregullta në edukimin fizik ata do të ushtrojnë në mënyrë aktive edhe në shkolla të ndryshme të Basketbollit.

Në këtë punim do të realizohen edhe këto detyra:

- Vërtetimi i ndikimit te parametrave themellore në karakteristikat morfologjike tek basketbollistët e rinj.
- Vërtetimi i korelacionit në aftësit lëvizore bazike tek basketbollistët e rinj.
- Vërtetimi i kroskorelacionit në aftësitë lëvizore situacionale tek basketbollistët e rinj.
- Vërtetimi i dallimeve ndërmjet karakteristikave morfologjike, testeve lëvizore bazike dhe situacionale në lojën e basketbollit.

3.1. HIPOTEZAT THEMELORE

Më qëllim të vërtetimit të saktë dhe shkencor të ndryshoreve të hulumtuara dhe objektivave primare janë paraparë këto hipoteza themelore:

H1 – Presim të paraqiten rezultate specifike statistikore në ndryshoret morfologjike për të katër ekipet e basketbollit së bashku.

H2 - Presim të paraqiten rezultate specifike statistikore në ndryshoret lëvizore bazike për të katër ekipet e basketbollit së bashku.

H3 - Presim të paraqiten lidhshmëritë e vlefshme ndërmjet katër ekipeve të trajtuara, me ndyshoret morfologjike, motorike bazike dhe asaj situacionale tek basketbollistët e katër ekipeve së bashku.

H4 – Presim se do të paraqiten dallime të vlefshme ndërmjet ekipeve të trajtuara në hapësirën morfologjike dhe motorike manifeste.

4. METODOLOGJIA E PUNËS

4.1 Mostra e entiteteve

Për realizimin e qëllimit të punimit është paraparë që mostrën ta përbëjnë basketbollistët e rinj të moshës 13-14 vjeç. Mostra e përgjithshme është 48 basketbollistë të rinj të cilët u takojnë katër ekipeve të ndryshme të basketbollit.

Grupin e Parë (I) do ta përbëjnë 12 basketbollistë të rinj të moshës 13-14 vjeç të ekipit të basketbollit "KB Kerasan Prishtina" nga Prishtina pjesëmarrës në Ligën e Kosovës për kategori të reja gjatë sezonit 2017/2018.

Grupin e Dytë (II) do ta përbëjnë 12 basketbollistë të rinj të moshës 13-14 vjeç të ekipit të basketbollit "M Junior" nga Prishtina pjesëmarrës në Ligën e Kosovës për kategori të reja gjatë sezonit 2017/2018.

Grupin e Tretë (III) do ta përbëjnë 12 basketbollistë të rinj të moshës 13-14 vjeç të ekipit të basketbollit "KB Vushtria Basket" nga Vushtria pjesëmarrës në Ligën e Kosovës për kategori të reja gjatë sezonit 2017/2018.

Grupin e Katërt (IV) do ta përbëjnë 12 basketbollistë të rinj të moshës 13-14 vjeçar të ekipit të basketbollit " KB Trepça" nga Mitrovica pjesëmarrës në Ligën e Kosovës për kategori të reja gjatë sezonit 2017/2018.

Si kushti i vetëm i përdorur gjatë përcaktimit të mostrës ka qenë që basketbollistët e përfshirë në hulumtim kanë pranuar me vetë dëshirë të jenë pjesë e këtij hulumtimi.

4.2 Mostra e ndryshoreve antropometrike

Mostra e basketbollistëve të rinj në këtë projekt i janë nënshtruar procedurave të testimit në kushte të njëjta, para fillimit të orës stërvitore për të katër ekipet. Grupin e parë të ndryshoreve e përbëjnë ndryshoret antropometrike dhe testet e aftësive lëvizore të karakterit bazik, ndërkaç grupin e dytë e përbëjnë ndryshoret situacionale tipike të lojës së basketbollit:

1	Lartësia e trupit	ALARTE
2	Pesha e trupit	APESHA
3	Gjatësia e krahut	AGJKTKR
4	Gjatësia e pëllëmbës së dorës	AGJAPDO
5	Gjatësia e këmbës	AGJATKËM
6	Gjatësia e shputës së këmbës	AGJATSHP

4.2.1 Përshkrimi i ndyshoreve antropometrike

- **Lartësia e trupit**

Lartësia e trupit është matur me antropometer. Me rastin e matjes subjekti duhet të jetë i zbathur dhe me veshje të lehta sportive dhe të qëndroj në bazë të fortë horizontale. Koka duhet të ketë atë pozitë ku arrihet horizontalja e Frankfurtit (skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale). Qëndrimi i trupit duhet të jetë i drejtë, shputat e bashkuara. Eksperimentuesi qëndron në të majtë të të eksperimentuarit, pasiçë kontrollon pozitën e tij dhe vendosjen e instrumentit, lëshon horizontalen e antropometrit deri në pjesën parietale të kokës. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto 1

➢ Pesha e trupit

Pesha e trupit është matur me peshoren me sustë e cila mundëson saktësinë e matjes prej 0.1 kg, treguesi rregullohet në pozitën zero. E domosdoshme është që peshorja të vëhet në pozitë horizontale. Subjekti është i zbathur, me veshje të lehta sportive, qëndron i qetë, në këmbë, në mes të peshores. Pasi që treguesi në peshore të qetësohet, rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 kg..

Foto 2

➢ Gjatësia e krahut

Gjatësia e krahut është matur me antropometër të shkurtuar. Subjekti qëndron drejt, me dorë dhe shuplakë të shtrirë, lehtësisht të larguar nga trupi. Njëri skaj i antropometrit vendoset në majë të gishtit të mesëm të dorës së majtë, kurse tjetri skaj (aty ku lexohet rezultati) në zgjatimin shpatullor (processus acromialis) të anës së njëjtë.
Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm

Foto 3

.

- **Gjatësia e pëllëmbës së dorës**

Matet me kompas rrëshqitës. Gishtërinjtë shtrihen anash në amplitudë maksimale, kompasi rrëshqitës vendoset në fallangjet e fundit të gishtit më të gjatë dhe në përfundim të shuplakës. Saktësia e matjes është 0.1 cm.



Foto 4

- **Gjatësia e këmbës**

Gjatësia e këmbës është matur me antropometër. Subjekti duhet të qëndrojë sikurse në matjen e lartësisë së trupit. Matja bëhet nga dyshemeja ku qëndron subjekti deri në pikën e quajtur "gjembi i sipërm i përparmë i çapokut" (spina iliaca anterior superior) të anës së majtë, e cila caktohet me gishtin e mesëm të dorës që mban pjesën horizontale të antropometrit. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto 5

- **Gjatësia e shputës së këmbës**

Matet me antropometër të shkurtuar. Subjekti qëndron ulur me këmbën e majtë të mbledhur që formon këndin e drejtë dhe me shputë vendosur në dysheme. Matësi ia vendosë krahët e antropometrit në thembër dhe në gishtin më të gjatë, (thonjtë duhet të jenë të prerë). Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1cm.

Foto 6

4.3 Mostra e ndryshoreve lëvizore bazike

Në bazë të mostrës se basketbollistëve të ekipeve dhe mosha e tyre përkatëse në këtë punim do t'i nënshtrohen procedurave të testimit në kushte të njëjta në këto ndryshore të motorikës bazike dhe asaj situacionale:

1	Kërcim nga vendi në largësi	MKGJATV
2	Kërcim nga vendi në lartësi	MKLARTV
3	Vrapim 20 metra nga starti i lartë V20	MVRAP20
4	Hudhja e topit Medicinal nga pozita ulur	MHEDHMED

4.3.1 Përshkrimi i ndryshoreve lëvizore bazike

- **Kërcim nga vendi në gjatësi**

Me këtë rast është vlersuar forca eksplozive e gjymtyreve të poshtme, pra gjegjësisht të muskujve. Mjetet: Shkumësi, apo stilolapsat me ngjyrë, shiriti metalik në centimetra. Shkëputja kryhet nga vendi me të dy këmbët. Janë të lejuara lëvizjet e hovit me duar, dhe ngritja në gishtërinj të këmbëve para shkëputjes. Shkëputja e dyfishtë nuk është e lejuar. Detyrat: subjekti kërcen sa më lartë që mundet dhe rënien duhet ta bëjë me të dy këmbët. Ekzekutohen dy deri në tri kërcime. Vlerësimi: gjatësia e kërcimit matet me distancën prej vijës së shtytjes e deri të gjurma më e afërt që e lenë pjesa e prapme e shputave, me rastin e rënies. Vlen rezultati i kërcimit më të gjatë i cili shënohet në centimetra. Rezultati në fletë testin përkatës shënohet me saktësi 1 cm.

Foto 7

➢ Kërcim nga vendi në lartësi

Me këtë test matim forcën eksplozive të muskujve.

Mjetet: Shkumësi, apo stilolapsat me ngjyrë, shiriti metalik në centimetra. Shkëputja kryhet nga vendi me të dy këmbët. Janë të lejuara lëvizjet e hovit me duar, dhe ngritja në gishtërinj të këmbëvepara shkëputjes. Shkëputja e dyfishtë nuk është e lejuar. Detyrat: subjekti kërcen sa më lartë që mundet me të dy këmbët dhe rënien duhet ta bëjë me të dy këmbët. Ekzekutohen dy deri në tri kërcime. Vlerësimi: gjatësia e kërcimit matet nga distanca kur subjekti prek pikën më të lartë me dorë (foto 1) deri tek distanca kur subjekti prek me dorë pikën më të lartë të kërcimit në foton 2 e cila arrihet pas shkëputjes maksimale në pjesën e majeve të gishtërinjve. Vlen rezultati i kërcimit më të gjatë i cili shënohet në centimetra. Rezultati në fletë në testin përkatës shënohet me saktësi 0.1 cm.

Foto 8

➢ Vrapimi 20 metra nga starti i lartë V20

Me këtë test matim shpejtësinë bazike.

Mjetet: Kohë matës, (Kronometër), shiriti ngjitës, kona për shënimin e startit dhe cakut.
Detyra: Subjekti qëndron me të dy këmbët pas vijës së startit, në pozicionin starti i lartë. Matësi jep komandën "gati" (pas së cilës subjekti përkulet para, me peshën në këmbën e përparme) dhe "tani" pas së cilës subjekti fillon vrapimin dhe tenton që maksimalisht shpejtë të vrapojë në distancën 20 m. Në momentin kur startuesi jep komandën "tani", duke lëshuar dorën prej pozitës horizontale – poshtë, matësi i kohës e nis matjen me kronometër dhe e ndalë atë kur subjekti e kalon me gjoks vijën e cakut.
Vlerësimi: matet koha prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.10sec.

Foto 9

➢ Hudhja e topit Medicinal nga pozita ulur

Ky test mat forcën e krahëve dhe forcën eksplozive.

Paisjet: Topi medicional, shiriti mates, shkumësi. Subjekti mban topin medicional me të dy duart, me këmbë të zgjeruar në gjerësinë e krahëve dhe e bënë hudhjen e topit medicional prej gjoksit. Topi tërhiqet afër gjoksit, pastaj hedhet fuqishëm para-jashtë sa më larg që është e mundur. Ekzekutohen tri tentime. Këndi i hedhjes së topit është i rëndësishëm. Duhet të sqaroni te subjekti këndin optimal për të arritur distancën maksimale të hedhjes, dhe të mundësoni disa prova para hedhjes. Për të mundësuar matjen më të lehtë, mund të shtrini shiritin matës përgjatë trajektores së hedhjes së topit. Regjistrohet distanca prej këmbeve të vendosura në vijën e fillimit tëshiritit matës deri ku hedhet topi. Matja regjistrohet në 5-10cm dhe merret rezultati i regjistruar i hedhjes më të mirë nga tri hedhjet e ekzekutuara. Shpina duhet të ruaj kontaktin me murin gjatë gjithë kohës.



Foto 10

4.4. Mostra e ndryshoreve lëvizore situacionale

1	Gjuajtja në kosh me dorën e djathtë	MGJKODOD
2	Gjuajtja në kosh me dorën e majtë	MGJKODOM
3	Gjuajtja në kosh me ndihmën e tabelës me dorën e djathtë	MGJKOTDD
4	Gjuajtja në kosh me ndihmen e tabelës me doren e majtë	MGJKOTDM
5	Gjuajtja në kosh nga distanca për 3 pikë	MGJKODIST
6	Driblimi në 20 metra me pengesa	MDRPE
7	Driblimi me top vajtje -ardhje në distancë 20 metra	MDRVARDH

4.4.1. Përshkrimi i ndryshoreve lëvizore situacionale

- **Gjuajtja në kosh me dorën e djathtë**

Me këtë test masim precizitetin e gjuajtjeve për një pikë me dorën e djathtë.

Mjetet: Top të basketbollit, një ndihmës, hapësira brenda 6.75m. Detyrat: subjekti i cili ekzekuton gjuajtjet duhet të qëndroj në hapësirën brenda 6.75m . I testuari merr topin nga ndihmësi dhe fillon gjuajtjet një pas një. Basketbollisti kryen kështu tri gjuajtje. Gjuajtjet duhet të egzekutohen sipas rregullave në lojën e basketbollit . Kohëzgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar. Vlerësimi: Numërohen shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës.

Foto 11

- **Gjuajtja në kosh me dorën e majtë**

Me këtë test masim precizitetin e gjuajtjeve për një pikë me dorën e majtë.

Mjetet: Top të basketbollit, një ndihmës, hapësira brenda 6.75m. Detyrat: subjekti i cili ekzekuton gjuajtjet duhet të qëndroj në hapësirën brenda 6.75m. I testuari merr topin nga ndihmësi dhe fillon gjuajtjet e një pas njëshme. Basketbollisti kryen kështu tri gjuajtje. Gjuajtjet duhet të gjuhen sipas rregullave në lojën e basketbollit. Kohëzgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar. Vlerësimi: Numërohen shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës

Foto 12

➢ Gjuajtja në kosh me ndihmën e tablës me dorën e djathtë

Me këtë test masim precizitetin e gjuajtjeve përmes ndihmës së tabelës me dorën e djathtë.

Mjetet: Top basketbolli, një ndihmës, hapësirën brenda 6.75m. Detyrat: subjekti i cili ekzekuton gjuajtjet duhet të qëndrojë në hapësirën brenda 6.75m. I testuari merr topin nga ndihmësi dhe fillon gjuajtjet e një pas njëshme me ndihmën e tabelës. Basketbollisti kryen kështu tre gjuajtje. Gjuajtjet duhet të gjuhen sipas rregullave në lojën e basketbollit. Kohëzgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar.Vlerësimi: Numrohen shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës.



Foto 13

➢ Gjuajtja në kosh me ndihmën e tabelës me dorën e majtë

Me këtë test matim precizitetin e gjuajtjeve përmes ndihmës së tabelës me dorën e majtë.

Mjetet: Top basketbolli, një ndihmës, hapësirën brenda 6.75m. Detyrat: subjekti i cili ekzekuton gjuajtjet duhet të qëndrojë në hapësirën brenda 6.75m. i testuari merr topin nga ndihmësi dhe fillon gjuajtjet e një pas njëshme me ndihmën e tabelës. Basketbollisti kryen kështu tre gjuajtje. Gjuajtjet duhet të gjuhen sipas rregullave në lojën e basketbollit. Kohëzgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar.Vlerësimi: Numrohen shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës.

Foto 14

- **Gjuajta në kosh nga distance për 3 pikë**

Me këtë test masim precizitetin e gjuajtjeve nga distanca prej 6.75 metrave.

Mjetet: 1 top të basketbollit, 1 ndihmës. Detyrat: subjekti i cili ekzekuton gjuajtjet duhet të qëndroj në distancë prej 6.75 metrave, pranon topin nga ndihmësi dhe fillon gjuatjet nga distanca 6.75 metra, pas gjuajtjes së parë lëvizë në pozitën 2. pranon topin nga ndihmësi dhe gjuan prapë, pastaj kalon në pozitën 3. gjuan me radhë deri sa të ekzekutoj gjuajtjen e tretë. Kohëzgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar. Vlerësimi: Numërohen shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës.

Foto 15

Driblimi në 20 metra me pengesa

Me këtë test masim shpejtësinë bazike, si dhe aftësitë individuale të sportistit në situatën e kontrollit të topit në shpejtësinë maksimale.

Mjetet: Kohë matës (Kronometër), kona. Detyra: Subjekti qëndron me të dy këmbët pas vijës së startit, në pozicionin start i lartë. Matësi jep komandën “gati” (pas së cilës subjekti përkulet para, me peshën në këmbën e përparme) dhe “tani” pas së cilës subjekti fillon vrapimin dhe tenton që maksimalisht shpejtë të udhëheqë topin në distancën 20 m në mes pengesave. Në momentin kur startuesi jep komandën “tani”, duke lëshuar dorën prej pozitës horizontale–poshtë, matësi i kohës e nisë matjen me kronometër dhe e ndalë atë kur subjekti e kalon me gjoks vijën e cakut. Vlerësimi: matet koha prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.10 sec.

Foto 16

- **Driblimi me top vajtje ardhje në distance 20 metra**

Me këtë test masim aftësitë anaerobe në gjatësi 20 metra "vajtje-ardhje", në raport me kohën.

Mjetet: topi i basketbollit, pipi për sinjalizim dhe kohë matësi. Detyra e subjektit është që duke udhëhequr topin të kalojë shtegun "vajtje-ardhje", me shpejtësi maksimale, por pa i thyer rregullat e driblimit dhe hapave. Startohet nga vija fundore deri te koni i vendosur në 20 metra, pastaj gjatë kësaj kohe bëhet një kthim dhe prapë vazhdohet udhëheqja e topit për 20 metrat e ardhshme. Rezultati vlerësohet me saktësi 0.01 sekonda.



Foto 17

4.5. Përshkrimi i instrumenteve të përdorura gjatë matjeve

Meqenëse morfologjia studion ndryshimet individuale të tipit fizik të njeriut, rritjen trupore në faza të ndryshme të zhvillimit, si dhe analizën e karakteristikave trupore të njerzve, të fituara nën ndikimin e faktorëve të jashëtm, shumica e të dhënave antropometrike janë fituar me matjet e dimensioneve të ndryshme trupore.
Për matjen e hapësires antropometrike janë përdorur këto instrumente matëse sipas Martinit:

- Antropometri i Martinit, i cili na mundëson saktësinë e matjes prej 0,1cm,
- Peshorja, e cila na mundëson saktësinë e matjes prej 0,1 kg,
- Shiriti mates (centimetrik).

Vlersimi i testeve motorike është bërë me ndihmën e disa paisjeve të domosdoshme me të cilat janë bërë matjet:

- Kronometri mekanik elektronik
- Konat plastik
- Metri matës
- Topi medicional,
- Ngjitës i letrës,

4.5.1. Përshkrimi i procesit të matjeve

Matjet antropometrike janë realizuar në orët e para të ditës përkatësisht prej ora 12.00h. Para startimit të matjeve të gjitha ekipeve ju janë dhënë informatat e nevojshme lidhur me pikat matëse dhe nga ana e matësve janë demonstruar pozitat e qëndrimeve gjatë matjeve. Ekipeve ju është treguar qëllimi i matjeve, në mënyrë që mos të krijohet huti gjatë procesit matës dhe që basketbollistët e rinj (ekipet) të jenë sa më të lirë, në mënyrë që bashkëpunimi të sjellë rezultate sa më të mira e më pozitive.

Matjet e parametrave antropometrike janë zhvilluar në hapësirat sportive (sallat e sportit) të cilat kanë qenë mjaftë të ndriçuara dhe me kushte të mira.

Instrumentet kanë qenë të standardizuara dhe të bazhdaruara para fillimit të matjeve dhe gjatë matjeve. Mostrat e matjeve përkatësishit basketbollistt e rinj kanë qenë këmbëzbathur, dhe të veshur me veshje sportive.

Nga ana e basketbollistëve këto matje janë pritur me interesim të madh e sidomos testet e precizitetit, kërcimit, vrapimit 20m dhe hudhja e topit medicional. Dimensionet e caktuara antropometrike çdo herë janë matur nga të njëjtit matës. Rezultatet e matjes janë lexuar deri sa testuesit kanë bërë matjet, përderisa personi i cili ka shkruar rezultatet për ti kontrolluar i ka përsëritur qartë e me zë të lartë në mënyrë që të mos ketë gabime gjatë shkruarjes së të dhënave.

5. METODA E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Bazuar në qëllimin primar të punimit dhe hipotezave të parashtruara është aplikuar metoda e përpunimit e të dhënave të cilat do të mundësojnë sigurimin e informatave për realizimin e qëllimit, duke shfrytëzuar programe adekuate për përpunimin e të dhënave programin SPSS për windows 23.00.

Për të katër grupet e sistemit të ndryshoreve janë llogaritur parametrat themelore statistikore për secilën ndryshore, si dhe masat asimetrike dhe të shpërndarjes normale:

- Mesatarja aritmetike
- Devijimi standard
- Rezultati maksimal
- Rezultati minimal
- Masat e asimetrisë
- Koeficienti i lakores

Për të vërtetuar ndërlidhjet ndërmjet ndryshoreve në hapësirën manifeste dhe ndërmjet hapësirave janë llogaritur raportet e tyre me sistemin e korelacionit sipas Pearsonit.

Ndërsa për të vërtetuar dallimet ndërmjet ekipeve rezultatet i kemi analizuar nëpërmjet T- Testit për grupeve të pavarura.

6. REZULTATET DHE DISKUTIMET

6.1 Treguesit themelor statistikor në hapësirëe antropometrike dhe motorike të basketbolliostëve për katër ekipet

6.1.1 Treguesit themelor statistikor në hapësiren antropometrike të basketbollistëve

Në këtë studim janë marrë 6 ndryshoret e hapësirës antropometrike, dhe mendohet se ky sistem i ndryshoreve e plotëson kriterin për një hulumtim të natyrës së masterit.

Në tabelën e pare 1. Janë paraqitur rezultatet e analizës deskriptive statistikore të basketbollistëve te të katër ekipeve të basketbollit tek të cilat testet antropometrike i kemi realizuar gjatë kohës së rregullt të stërvitjeve me trajnerët e tyre poashtu edhe testet motorike i kemi realizuar gjatë stërvitjeve te të katër ekipeve.

Në tabelën e 1 (pare) janë dhënë rezultatet statistikore deskriptive ku janë shënuar në këtë mënyrë: rezultati minimal (min), maksimal (max), mesatarja aritmektike (mean), devijimi standart (std.dev), masat e asimetris (skew dhe kurt) dhe numri i lojtarëve (N).

Duke analizuar matricën e paraqitur nga rezultatet e fituara në tabelën numër.1 vërehen vlera normale të fituara ndërmjet rezultatit minimal dhe maksimal të reflektuara nga devijimi standart, përvec peshës së trupit të cilat tregojnë për një devijim më të lartë në vlerë prej (13.73) që tregon për një disporporcion ndërmjet lojtarëve.

Tabela 1 Parametrat themelor statistikor në hapsirën antropometrike të basketbollistëve

Ndryshoret	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.
ALARTE	48	152,00	194,00	168,12	9,38	,654	,149
APESHA	48	36,70	103,20	61,01	13,73	,637	1,116
AGJATKR	48	69,00	97,00	78,53	6,32	,542	,098
AGJAPDO	48	16,00	26,30	19,66	2,18	1,105	1,074
AGJATKËM	48	95,00	121,00	104,60	6,35	,689	,157
AGJATSHP	48	23,00	30,00	25,75	1,55	,438	-,178

6.1.2 Treguesit themelor statistikor në hapësiren motorike të basketbollistëve

Në tabelën 2 janë paraqitur rezultatet e analizës themelore statistikore deskriptive te testeve të motorikes bazike dhe asaj situacionale për të gjithë basketbollistët së bashku. Në këtë hulumtim janë aplikuar 11 ndryshore të motorikës bazike dhe testeve situacionale të lojës së basketbollit, ku mendohet se ky grup ndryshoreve motorike bazike dhe atyre situacionale e mbulojne mjaftueshëm punën në këtë studim të master.

Në këtë tabelë janë paraqitur rezultatet e analizës deskriptive statisikore: numri i lojtareve (N), rezultati minimal (min), maksimal (max.), mesatarja aritmetikore (mean) , devijimi standard (std. dev), masat e asimetrisë (skeë dhe kurt). Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë për të arriturat e nxënësve në hapësiren e motorikës bazike dhe asaj situacionale dhe nëpërmjet analizës deskriptive të statistikës themelore mund të vërejmë se rezultatet janë më homogjene vetëm tek testi i forcës eksplozive kërcim së gjati nga vendi ku kemi një dallim më të madh dhe është paraqitur vlera më e lartë e devijimit standard (20.58) ku dallojnë vlerat ndërmjet minimalës me (138.00)cm dhe maksimales me (227.00)cm.

Ndërsa vlerat e tjera nxënësit i kanë paraqitur pothuajse të përafërta që mund të themi se në hapësirën motorike ka një shtrirje simetrike të rezulateteve në skewness edhe kurtosis të cilat vërtetojnë për një grup përafërsisht të njëjtë.

Tabela 2.Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën motorike të basketbollisteve

Ndryshoret	N	Min.	Max.	Mean	Std. Dev.	Skew.	Kurt.
MKGJATV	48	138,00	227,00	172,89	20,58	,552	,319
MKLARTV	48	26,00	52,00	37,70	5,92	,351	-,337
MVRAP20	48	3,49	4,68	3,97	,29	,206	-,586
MHEDHMED	48	1,21	3,95	2,46	,67	,165	-,389
MGJKODOD	48	0,00	3,00	1,04	,77	,219	-,532
MGJKODOM	48	0,00	2,00	,58	,65	,661	-,510
MGJKOTDD	48	0,00	2,00	,83	,59	,058	-,211
MGJKOTDM	48	0,00	2,00	,48	,62	,927	-,100
MGJKODIST	48	0,00	2,00	,50	,68	1,040	-,112
MDRPE	48	4,00	6,66	4,81	,55	1,061	1,651
MDRVARDH	48	8,16	11,53	9,52	,71	,842	1,133

6.3. Korelacionet e ndryshoreve manifeste

6.3.1 Korelacionet ndërmjet ndryshoreve në hapësiren antropometrike manifeste të basketbollisteve

